



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. Prot.
1653/1

Tiranë, më 08.07 2025

NJOFTIM
PËR APLIKIM PËR EKSPERT TË JASHTËM SPECIALIST IT

(angazhim me kontratë shërbimi)

Në zbatim të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit" i ndryshuar, neni 73, pika 3, neni 101, pika 1, Universiteti i Sporteve të Tiranës kërkon 1 (një) Specialist IT si ekspert i jashtëm (të angazhuar me kontratë shërbimi), për të qenë pjesë e Grupeve të Punës në procedurën e prokurimit "Paisje kompjuterike".
Specialist IT duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare sipas fushës së kërkuar, (Teknologji Informacioni, Informatik, Inxhinjeri Informatike ose ekujvalentë).
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 1 (një) vitë.
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë brenda datës 11.07.2025, në zyrën e Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
- Vetëdeklarim mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

Mënyra e vlerësimit: Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje.

ADMINISTRATORI

Haxhirete Sulaj

